

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 9-2019

INTEGRIMI EUROPIAN

Afërdita Duraku

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Political Science Commons](#)



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

INTEGRIMI EUROPIAN
Shkalla Bachelor

Afërdita Duraku

Shtator/ 2019
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

Punim Diplome
Viti akademik 2014/2015

Aferdita Duraku

INTEGRIMI EUROPIAN

Mentor: Dr. Ilir Zylfiu

Shtator/ 2019

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Integrimi Evropian do të thotë kultivim të unitetit ndërmjet vendeve dhe popujve evropianë. Brenda Bashkimit Evropian, do të thotë se vendet i grumbullojnë resurset e veta dhe bashkarisht marim shumë vendime. Kjo marje e vendimeve të përbashkëta realizohet nëpërmjet bashkëpunimit dhe bashkëveprimit nëpërmjet Institucioneve të Bashkimit Evropian siç janë Parlamenti i BE, Këshilli i BE, Komisioni i BE etj. Integrim Evropian është proces integrimi politik, legal, ekonomik dhe në disa raste edhe social dhe kulturor i vendeve Evropiane. Procesi i Integritimit Evropian kërkon një punë të përbashkët nga të gjitha institucionet qeveritare të një shteti dhe gjithë resurset politike duhet që të aktivizohen në këtë drejtim dhe të shërbejnë drejtpërdrejt në arritjen e këtij objekti strategjik, që synojnë të gjitha shtetet e kontinentit Evropian. Analitikët e integrimeve evropiane në rend të parë të lidhjeve ndërrajonale e definojnë evropianizimin si proces i reredefinimit të politikave kombëtare dhe drejtimet e veprimit të tyre deri në shkallë të ndërmjetme të vetëqeverisjes së pushtetit lokal apo në rajone, ku dinamika politike dhe ekonomike e Bashkimit Evropian si pjesë e logjikës organizative ka për bazë mu rajonin si motor të integrimeve në nivele të ndryshme. Në këtë proces paraprijnë vendet me demokraci të përparuar e të qëndrueshme, me potencial ekonomik, teknologjik, shkencor e ushtarak modern, të integruar gjithnjë e më shumë edhe në struktura të përbashkëta. Bashkëudhëtarë të këtij zhvillimi për progres të gjithanshëm janë edhe mjaft popuj e vende, evropiane dhe të tjerë, pavarësisht nga madhësia e tyre. Integrimi evropian dhe euroatlantik është një proces gjithëdimensional përherë e më i ndërvarur, që përfshin zhvillimin tërësor të shoqërisë demokratike, legjislativin dhe institucionet, ekonominë e tregut dhe teknologjinë, politikën për sigurimin kombëtar, rajonal e më gjërë dhe strukturat përkatëse, kohezionin social dhe respektimin real të të drejtave të njeriut e të minoriteteve, shërbimin shëndetësor, arsimin, shkencën, kulturën etj.

MIRËNJOHJE DHE FALENDËRIME

Falënderimet më të sinqerta janë për profesorin-mentorin, Prof.Dr Ilir Zylfiu, për udhëzimet dhe drejtimin e këtij punimi Diplome.

Prof.Zylfiu ishte gjithmonë i gatshëm për ndihmë dhe drejtim të qartë dhe mbështetje të pakursyer deri të përfundimi i këtij punimi.

Falënderoj Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), posaçërisht Departamentin Shkenca Politike -Administratë Publike, që na ofruan mundësinë dhe na përkrahën deri në fund, pa të cilin ky punim Diplome nuk do të mund të realizohej.

Falënderime për familjen time për përkrahjen dhe durimin që treguan deri në përfundimin e këtij punimi Diplome.

Shtator, 2019

Prishtinë

PËRMBAJTJA

1	HYRJE	1
2	SHQYRTIMI I LITERATURËS	2
3	DEKLARIMI I PROBLEMIT	6
3.1	Procesi i integritit evropian.....	6
3.2	Bashkësia evropiane për thëngjill dhe çelik.....	7
3.3	Bashkësia ekonomike evropiane.....	8
3.4	Bashkësia evropiane për energjinë bërthamore	9
3.5	Roli i BE-së në procesin e ndërtimit të institucioneve në Kosovë.....	10
3.6	Komisioni European.....	11
3.7	Këshilli i BE-së.....	12
3.8	Këshilli European – Samiti i BE-së.....	13
3.9	Parlamenti European.....	13
3.10	Gjykata Europiane e Drejtësisë.....	15
3.11	Banka Qendrore Europiane	15
3.12	Komiteti për Çështje Ekonomike dhe Sociale.....	15
3.13	Komiteti i Rajoneve	16
3.14	Banka Europiane për Investime	16
4	PROCESI I ANTARËSIMIT NË BE	17
4.1	Përmbushja e Kritereve (Kriteret e Kopenhagës)	18
4.2	Kriteret politike-juridike:	19
4.3	Kriteret ekonomike:	19
4.4	Kriteret Europiane.....	19
4.5	Procesi i antarësimit në UE.....	20
4.6	Forcimi i shtyllës ligjore dhe përshtatja e legjislacionit të Kosovës.....	25
4.7	INSTITUCIONET E BE-SË.....	26
5	DEKLARIMI I PROBLEMIT	27
6	METODOLOGJIA	28
6.1	Objektivi i studimit	28

6.2	Qëllimi i studimit.....	28
7	PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....	29
	REFERENCAT	30

FJALORI I TERMAVE

BE- Bashkimi Evropian

BB- Banka Botërore

EULEX - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë

NATO - Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior

UNHCR- Zyra e Komisionit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara

SAA- Marrëveshja për Stabilitet dhe Asocim

ESDP- Politika Mbrojtëse e Sigurimit Evropian

CFSP- Sekretari Gjeneral, Sekretari i Këshillit dhe Komisionit Evropian

1 HYRJE

Të jesh i integruar në Europë është në radhë të parë privilegj e jo detyrim, dhe është preokupim me reforma në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Shoqërite njerëzore moderne, të organizuara në demokraci pluraliste dhe në shtete të së drejtës, punojnë për të përmirësuar të sotmen dhe për të përgatitur zhvillimet e të ardhshmes. Përmasat kryesore të këtij procesi tërësor janë demokracia dhe prosperiteti ekonomik, sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm, kontributi për paqen në shkallë të gjerë, emancipimi i gjithanshëm i individit dhe i shoqërisë. Në këtë hapësirë shtohen si të drejtat dhe liritë e njeriut e të minoriteteve ashtu edhe mundësitë për respektimin e tyre.

Integrimi nuk duhet keqkuptuar si eliminim i thjeshtë kufijsh, i cili do të bëjë të mundur lëvizjen e lirë drejt vendeve më të pasura të Europës. Integrimi në Bashkimin European nënkupton, në radhë të parë, përafrimin dhe përqaftimin e vlerave themelore mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe jeton ky organizëm i madh ndërshtetëror: Demokracia, shteti i së drejtës, mbrojtja e të drejtave të njeriut, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të pakicave kombëtare. Të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit European funksionojnë mbi bazën e demokracive liberale, në të cilat shteti i së drejtës është i konsoliduar, ligji është i barabartë për të gjithë dhe të drejtat e njeriut janë të shenjta. Përqaftimi i vlerave të demokracisë është vendimtar dhe themelor për vendet që aspirojnë për anëtarësim në BE. Në këto rrethana, një pjesë e konsiderueshme e ndihmës së akorduar nga BE për vendin tonë synon pikërisht në ndërtimin e këtyre vlerave. Ekonomi funksionale tregu, e aftë t'i bëjë ballë presioneve konkurruese dhe forcave të tregut brenda BE-së. Përmbushja e dy kriterëve të mësipërme, së bashku me detyrimin për të adoptuar legjislacionin e Bashkimit European, të ashtuquajturin *acquis communautaire*, janë parakushti kryesor për të mundësuar futjen e shteteve të treta në Bashkimin European. Për shkak të një historie të gjatë izolimi e vështirësish ekonomike, integrimi perceptohet shpesh si mundësi për të lëvizur në Europë, duke lënë në harresë faktin se kjo lehtësi vjen vetëm si rezultat i konsolidimit të demokracisë dhe zhvillimit të ekonomisë. Procesi i integritit duhet kuptuar si një program reformash që e afron vendin me modelin european të shtetit, demokracisë dhe funksionimit të ekonomisë, por jo thjesht si lëvizje e lirë drejt perëndimit.

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS

Studiuesit që janë marrë me historinë e Bashkimit Evropian e nisin atë me vitet e pasë luftes së dytë botërore. Shekulli XIX ka qenë koha e krijimit të shteteve kombeve në Evropë. Revolucionet dhe lëvizjet nacionale që shpërthyen në vitin 1848 u drejtuan kundër perandorive Evropiane të krijuara me forcën e armëve të dinastive të fuqishme të cilat mbanin nën shtypje kombe të tjera. Përkushtimi për të patur një perspektivë të ardhme Kosova varet kryekëput nga qytetarët e vendit dhe institucionet e saj, duke vazhduar pa hezitim në reformimin e terësishëm në sektorët politikë, ekonomikë dhe atë juridik, si një parakusht bazë drejt integriteteve evropiane. Kësisoj u shpreh edhe presidenti i KE-së Hoze Manuel Baroso, kur vizitoi Kosovën duke adresuar qartë se “se e ardhmja varet në tërësi nga qytetarët e Kosovës. Ne do t’i ndihmojmë, por qytetarët dhe institucionet duhet të vazhdojnë reformat, konsolidimin e demokracisë, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, dhe marrëdhënie të mira fqinjësore.

Një element kyç që nuk duhet lëshuar pe është edhe demokratizimi i institucioneve si proces, që është shumë i rëndësishëm dhe shumë domethënës për Kosovën, ngase pa institucione demokratike ne nuk mund të jemi në rrugët evropiane. Në këto procese jemi paksa mbrapa. Duhet të punohet intensivisht që Kosova të ketë institucione demokratike, një proces zgjedhor demokratik mos manipulime me votën e qytetarit. Suksesi arrihet nëse ne i zhdukim këto dukuri, kjo njëherit do të jetë edhe pavarësi i dytë për qytetarët dhe shtetin. Aty ku nuk ka liri dhe demokraci mungon një demokratizim institucional, një gjygjësor të pavarur, në respektimin e të drejtave të njeriut, investime të lirshme ku të gjitha këto kanë një thelb të përbashkët demokracinë dhe lirinë. Ka shumë gjëra që në Kosovë nuk shkojnë si duhet, ndoshta edhe nuk kuptohen aq sa duhet nga institucionet tona.

Në një vend, ku nuk dihet çka është privatja e çka zyrtarja nuk duhet që Kosova të konsiderohet si një pronë private e institucionit të caktuar, ne nuk e ndryshojmë dot imazhin demokratik nëse nuk ndryshojmë kulturën politike, duke luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin, përmirësim në gjygjësor, lirinë e mediave. Një adresim të ngjashëm dha edhe kryetari i Parlamentit Evropian Jezy Buzek ku ndër të tjera tha se: “nuk ka vend të lirë ku nuk ka liri të shprehjes”, edhe adresisht nga raportimet e Brukselit vjen

një mosrespektim i lirisë së mediave se ekziston një mungesë e përgjithshme e sundimit të ligjit në Kosovë. Një sfidë mbetet korrupsioni në të gjithë vendin në nivele të ndryshme që gjerësisht e shtrembërojnë demokrazimin e institucioneve, dhe e çrregullojnë demokratizimin e vendit. Ndonjëherë dhe mund ta fundosin politikën, si dhe përkeqsojë imazhin e Kosovës në zhvillimin ekonomik. Duhet t'i jepet më shumë rëndësi jetës sociale, luftimit të varfërisë, papunësisë duhet luftuar rreptësisht këto dukuri shoqërore. Përmirësimi i institucioneve sidomos i Kuvendit të Kosovës në bërjen e punëve më efikase, përmirësim në administratën publike, keqqeverisja duhet përmirësuar këto dhe shumë çështje të tjera janë njëherit edhe adresime që vijnë nga BE-ja. Prandaj, ne duhet me çdo kusht në mos hezitim në këto rrugëtime, ngase janë të dobishme dhe në favor të zhvillimit të shtetit dhe afrimin e tij me shtetet e rajonit dhe shteteve të BE-së.

Aspektet të veçanta të zhvillimit të idesë për Bashkimin Evropian mbas luftës së dytë botërore

Pas përfundimit të luftës së dytë botërore kishte si pasojë një ndërrim rrënjësor të raporteve të forcave në Evropë, ku si fitues të vërtetë dulin SHBA-të si dhe bashkimi sovjetik.

Në epërsinë ushtarake që kishin këto dy shtete sinonin të vendosnin edhe për fatin e Evropës, ku ndodhi më vonë siç dihet historikisht.

Nga Lufta e Parë Botërore të dobësuar nga kriza e madhe ekonomike botërore, si dhe nga Lufta e Dytë Botërore Fuqitë e Mëdha Evropiane në përjashtim të Bashkimit Sovjetik humbën pozicionet e veta politike si dhe strategjike që mbanin deri atëherë në aspektin ndërkombëtar. Nga lufta doli si humbës vetëm Gjermania, por edhe shtetet tjera që pas Luftës së Dytë Botërore ishin vetëm dy fuqi botërore SHBA-të dhe Bashkimi Sovjetik.

Shtetet evropiane ju parashtruan dy detyra që së bashku ta ndalojnë konfliktet ushtarake dhe ta kthejnë ndikimin e mëparshëm politik dhe ekonomik në botë, dhe lidhur më këtë shtetet evropiane ishin të vetëdijshme se vetëm të bashkuar do të mundë të kryenin këto detyra.

Iniciatori për realizimin e idesë së kahmotshme të bashkëpunimit më të ngushtë politike, ekonomike e kulturore në mesë shteteve evropiane pasë Luftës së Dytë Botërore njihet kryeministri britanik Ëinston Churcill 1874-1965, i cili më 19-09-1946 në fjalimin e

tij në Zurich-ut në lidhje me gjendjen katastrofale ekonomike dhe sociale në Evropë, për ta tejkualuar këtë gjendje ai kërkon formimin e shteteve të bashkuara të Evropës.

Kjo ide nuk ishte asgjë e re, por roli që luajti ajo më vonë për integrimin evropian ishte shumë i madhë pasi që kjo ide kësaj here vinte nga një anë qeveritare në rrethana të reja, pasi që vetëdija për nevojën e një bashkëpunimi më të ngushtë politik, ekonomik si dhe kulturor në mes të shteteve evropiane ishte shumë më e lartë.

Arsyet që e bënë një bashkëpunim të tillë te domosdoshëm ishin: rindërtimi, tejkalimi i ideologjisë totalitare nacionalizmi dhe fashizmi si dhe konfliktet lindje perëndim (që njihet si “Lufta e Ftohtë”), që bëri që të gjitha planet për integrim evropian të realizohen ndaras në gjithë Evropën Perëndimore dhe Lindore.

Njëkohësisht vlen të theksohet se Lufta e Ftohtë ishte një shtytje që e përshpejtoj integrimin perëndimor evropian si masë mbrojtëse përballë atij lindor.

Në të dy pjesët e Evropës u formuan organizata politike, ekonomike dhe ushtarake si p.sh në Evropën perëndimore: Këshilli i Evropës që kishte mekanizëm juridik konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në Evropën lindore u formuan: Pakti i Varshavës, Këshilli për ndihmë reciproke ekonomike, si një varg organizatash tjera.

Me rënjen e sistemit monist në Evropën lindore, këto organizata u shuan për të ju bashkuar më vonë integrit Evropian perëndimor. Dëshira më e mirë për këtë është antarësimi i ish-anëtarëve të paktit të Varshavës si: Çekia, Polonia, Rumania, Bullgaria e të tjera.

Me përjashtim të mekanizmit të akteve perfundimtare të konferencës për siguri dhe bashkëpunim në Evropë, që nga viti 1975 ishte e vetmja organizatë evropiane që kishte shtrirje në lindje dhe perëndim në Evropën deri në fillimet e viteve të 90-ta nuk kishte ndonjë organizatë që kishte për bazë një integrim të përbashkët evropian.

Realizimi i saj deri më sot, realizimi i idesë për një bashkim gjegjësisht për një integrim të përbashkët evropian është një proces i cili është zhvilluar nëpër etapa të ndryshme dhe njëkohsisht që edhe sot është në zhvillim e sipër, sepse caku që ka pasur për bazë ideja kamotshme, e për një integrim evropian është mjaft larg nga ajo që është arritur deri me sot në gjithë sferën e integrit Evropian, përkundër faktit se tani në një pjesë të Evropës

është arritur të bëhet heqja e kufijeve, taksat doganore apo edhe të vendoset një valutë e përbashkët.

Njëra ndër arsyet kryesore pse deri me tani nuk ishte e mundur që ideja për integrim evropian të realizohej më shpejtë janë: ndarja e Evropës pas Luftës së Dytë Botërore në dy blloqe lindje perëndim, paragjykimet e llojeve të ndryshme dhe interesat e ndryshëm, politik, ekonomik si dhe strategjik të vendeve evropiane.

Ky fakt ka dalë disa herë mbi sipërfaqe edhe gjatë konferencës të Kopenhagës në dhjetor të vitit 2002 në të cilin u mor vendim për zgjerimin më të madh të Bashkimit Evropian në gjithë historinë e tij. Një pjesë e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian i kishte rezervat e veta kundrejt anëtarimit të disa shteteve kandidate me arsyetimet që nuk i përmbushin standardet e përcaktuara në nenin 2 të kontratës mbi Bashkimin Evropian.

Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian nuk i shprehnin rezervat e tyre vetëm sa i përket respektimit të drejtave të njeriut, ku Turqia në të kaluarën ka bërë shkelje sistematike të drejtave të njeriut, e sidomos në çështjen Kurde, por ato shprehin rezervat edhe për faktin që Turqia është një shtet Islamik dhe si i tillë me arsyetimin kinse nuk do mundet ti përshatet rendit shoqëror evropian dhe kështu mundet të nxjerr nga balancimi vetë Bashkimin Evropian.

Një dëshmi tjetër për interesat e ndryshme politike e gjeostrategjike të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian është edhe çështja e pavarësisë së Kosovës.

Përkrahja e Kosovës siç dihet nga vendet e Bashkimit Evropian ka intensitet të ndryshëm, 5 vendet anëtare ende refuzojnë të njohin Kosovën si shtet të pavarur e sovran, kjo tregon se sa paragjykime duhet të tejkalohë Evropa për të finalizuar në tërësi idenë për një Evropë të bashkuar. Divergjencat vazhduan dhe më vonë në lidhje me rastin e nënshkrimit dhe ratifikimit të marrëveshjes së Lisabonës, e cila në vete përmban një epokë të re sa i përket bashkëpunimit, afrimit apo dhe integritetit evropian. (*Milo, 2002, fq.11-32*).

3 DEKLARIMI I PROBLEMIT

3.1 Procesi i integritit evropian

Procesi i integritit evropian është zhvilluar në etapa të ndryshme për shkak të arsyeve të ndryshme objektive e subjektive që kanë ndikuar në zhvillimin politik ekonomik e shoqëror në Evropë. Ndërmjet bashkëpunimit të shteteve evropiane në fusha të ndryshme si fillim ka ardhur deri të formimi i organizatave ndërkombëtare evropiane me qëllimin që të thellohet bashkëpunimi në mes shteteve evropiane. Roli i BE-së, paraqiti një gadishmëri që të mbikëqyrej roli i Kosovës nga ana e UNHCRsë 1244, që të jetë në involvim të plotë me implementimin e së ardhmës së statusit. Prezanca e niveleve të larta të Këshillit, CFSP (Sekretarit Gjeneral, Sekretarit të Këshillit dhe Komisionit European), të cilët paraqitën tre raporte për Kosovën, si “Roli i së ardhmës së BE-së dhe kontributi i saj në Kosovë”.

Këta së pari propozuan që: “Të ardhmen e prezencës ndërkombëtare, dhe zyrat ndërkombëtare me rëndësi nga ana e BEsë”, argumentet vazhduan me prezencën ushtarake, që ishte nën udhëheqjen e NATO-së, brenda udhëheqjes së ESDP-së (Politika Mbrojtëse e Sigurimit European), dhe si detyrë e BE-së në vazhdim do të jetë mbrojtja e minoriteteve, sundimi i ligjit dhe i rendit.

Në raportin e dytë të Solanës dhe Rehne, BE-ja pas statusit të Kosovës, si një ndër çështjet me rëndësi, ishte edhe çështja e ruajtjes së rendit dhe të ligjit, përmes politikave të ESDP-së.

Në pikën e tretë, paraqiten “implementimet e zgjidhjes së statusit dhe problemet në ekonominë fiskale”, kompetenca e prezencës ndërkombëtare në të ardhmen për Kosovën me disa intervenime dhe bashkëpunim me shtetin e Kosovës. Kjo ishte një rrugë e paraqitjes ndërkombëtare, bashkëpunimi dypalëshe, nga prezenca speciale e BE-së, do të ndihmonte operatorin e ESDP-së, në mbrojtjen e rregullave dhe rendit. Zyrat e Komisionit në Kosovë do të merrnin punimet nga Komisioni European në Kosovë.

Ndihmat e organizatave nga ana e Komisionit European dhe Bankës Botërore, në zgjedhjen e statusit, do të paraqesin Kosovën në një zhvillim evropian. Ndryshimet e politikës së jashtme të institucioneve të BE-së, luajtën një rol në procesin dhe gjendjes eventuale pas

statusit, nën prezencën e BE-së. BE-ja është duke luajtur rol të rëndësishëm në stabilizimin e rajonit përmes mjeteve politike dhe të sigurisë (ESDP). (*Zahiti, fq. 28-29*).

3.2 Bashkësia evropiane për thëngjill dhe çelik

Themelimin e bashkësisë evropiane për thëngjill dhe çelik qëllimi kryesor ka qenë që prodhimin gjerman të thëngjillit dhe çelikut i cili kishte domethënie të madhe ushtarake ekonomike për ta vënë në kontroll ndërkombëtare.

Është pretenduar që në mënyrë preventive të evitohet rreziku i mundshëm për paqen, që do të mund të vinte nga Gjermania e rirforuar.

Duke pasur parasysh konfliktin lindje-perëndim dhe në bazë të përvojës së hidhur me marrëveshjen e Versajit, si Franca ashtu edhe shtetet e tjera ishin në dijeni se një veprim i këtij lloji do të kishte sukses vetëm në Gjermani së bashku me shtetet e tjera do të inkuadroheshin në një sistem supranacional.

Hapi i parë në këtë drejtim do të bëhej të një federatë evropiane dhe njëkohësisht do të sigurohej baza juridike për ta krijuar një bashkësi shumë të madhe dhe unike.

Ministri francez Robert Schuman për herë të parë ju prezantoi opinionit publik konceptin për themelimin e bashkësisë evropiane për thëngjill dhe çelik, në të cilin përpilimin e tij e kishte bërë bashkëpunatori i tij i ngushtë Jean Monnet.

Edhe pse ky plan ndërkombëtarisht njihet si plani i Schumanit, meritat më të mëdha i ka Jean Monnet.

Gjermania, Italia dhe shtetet e Beneluksit, mbas një kohë bisedimesh dhe konsultash, duke marrur parasysh faktin se interesat e tyre nacionale më së miri do të mund t'i mbronin në një bashkësi pranuan ofertën e dalë nga Shumann dhe me 18 prill 1951 në Paris u nënshkrua kontrata mbi themelimin e bashkësisë Evropiane për thëngjill dhe çelik, e që hyri në fuqi me 23 korrik 1952, ku kjo kontratë njihet edhe si kontrata e Parisit apo Mauntan-it.

Qëllimi i kësaj kontrate ishte krijimi i një tregu të përbashkët të thëngjillit dhe çelikut, zbatimin e një politike të përbashkët ekonomike dhe sociale, e përbashkët në të njëjtin sektor merceologjik, para së gjithave krijimin e institucioneve të përbashkëta të destinuar ta ndjekin qëllimi e kontratës. Tregu i përbashkët i thëngjillit mbështetej në krijimin e një

zone të shkëmbimit të lirë në mes të shteteve anëtare, e bazuar në shfuqizimin sipas kushteve të caktuara dhe brenda periudhës së caktuar kohore, të taksave doganore, importit dhe eksportit dhe taksave të tjera në efekt ekuivalent, kufizimi sasior në qarkullimin e prodhimeve në shfuqizimin e masave që diskriminojnë ndërmjet prodhuesve, blerësve ose konsumatorëve ,e veçanërisht kushtet e çmimit dhe të dorëzimit të mallrave. (Zahiti: fq. 29-30).

3.3 Bashkësia ekonomike evropiane

Në bazë të përvojave të fituara nga themelimi i bashkësisë evropiane për thëngjill dhe çelik, ishte e qartë se integrimi evropian mund të arrihej hap pas hapi.

Duke u bazuar në suksesin e bashkësisë evropiane për thëngjill dhe çelik dhe me qëllim të qarjes së integritit evropian në hap përpara, me 23 korrik 1957 në Romë u themeluan dy bashkësi evropiane: bashkësia ekonomike evropiane dhe bashkësia evropiane për energji bërthamore që është njohur ndryshe si Euroatomi, ku me 1 janar të vitit 1958 këto dy kontrata kanë hy në fuqi.

Mbi themelimin e bashkësisë ekonomike evropiane në bazë të pozitës të nenit 2 të kontratës, krijimi i bashkësisë ekonomike evropiane e kishte për qëllim krijimin e një tregu të përbashkët të përgjithshëm, afrimin gradualisht të politikave ekonomike të shteteve anëtare, një zhvillim të tërësisë së veprimtarive ekonomike e të bashkësisë një përmirësim të jetesës dhe mardhënieve midis shteteve që marrin pjesë në të, duke ja besuar ndjekjen e qëllimeve si dhe mbikëqyrjen e respektimit të detyrimeve që shteteve anëtare u rrjedhin nga kontrata e institucioneve që ishin vetëm të përbashkëta në atë kohë me ato të bashkësisë evropiane për thëngjill dhe çelik.

Në dispozitën e nenit 3 të kontratës mbi themelimin e bashkësisë ekonomike evropiane ishte paraparë që të krijohej tarifa e përbashkët doganore dhe një politik tregtare e përbashkët kundrejt shteteve të treta, shteteve jo anëtare të bashkësisë evropiane.

Me themelimin e bashkësisë ekonomike evropiane, synimi ishte që të arrihej në radhë të parë një bashkëpunim i ngushtë ekonomik por edhe politik në mes të shteteve anëtare.

Edhe nga dispozita e nenit 312 të kontratës mbi themelimin e bashkësisë evropiane kjo dëshmohet (neni 356 i kontratës mbi mbarëvajtjen e punës të bashkimit evropian tash), ku përcaktimi është bërë se bashkësia është themeluar për një kohë të pa caktuar.

Qëllimi për të cilin ishte themeluar bashkësia ekonomike evropiane nuk kishte të bënte vetëm në mënyrë specifike me qarkullimin e lirë të mallrave, por edhe liberalizimin e qarkullimit të personave, të shërbimit e të kapitalit mbrenda hapsirës së bashkësisë ekonomike evropiane.

Në këtë kishte përfshirë edhe qarkullimi i lirë i personave juridik në pergjithësi të shoqërisë që zhvillojnë aktivitete industriale apo edhe tregtare në vendet anëtare. (*Zahiti, fq. 30-31*).

3.4 Bashkësia evropiane për energjinë bërthamore

Me 23 prill të vitit 1957 në Romë së bashku me bashkësinë ekonomike evropiane është themeluar edhe bashkësia evropiane për energjinë bërthamore ose euroatomi.

Qëllimi i krijimit të kësaj bashkësie sipas dispozitës së nenit 1 të kontratës mbi themelimin e organizatave evropiane që në këtë mundësohet krijimi i premisave të nevojshme për lindje dhe rritjen e shpejtë të industrisë bërthamore, rritjen e standardit jetësor dhe zhvillimin e shkëmbimeve në këtë drejtim në vendet e tjera.

Neni 2 i kontratës në bazë të dispozitës për arritjen e qëllimeve themeluese bashkësia evropiane për energji bërthamore obligohet që të zhvillon hulumtim shkencorë, të kontriboj në përhapjen e njohurive teknike, të krijojë norma unike ligjore për mbrojtjen e shëndetit të popullsisë e të puntorëve si dhe të garantohet zbatimi i tyre, që të ndihmojë më pastaj investimet në lidhje me energjinë bërthamore të sigurohet furnizimi i rregullt të shfrytëzuesve të bashkësisë me lëndë të para apo me lëndë shpërbërse që të sigurojë një mbikëqyrje të efektshme që se apo shfrytëzohet energjia bërthamore për qëllimin që është destinuar.

Për zbatimin sa më efektiv të gjitha këtyre detyrimeve lidhur me furnizimin në nenin 52 të kontratës mbi themelimin e bashkësisë evropiane për energjinë bërthamore, është caktuar një agjensi e cila do të drejtonte si dhe të mbikëqyrte punët. Bashkësia evropiane për energjinë bërthamore është themeluar për një afat të pa caktuar, kontrata mbi themelimin e

bashkësisë evropiane për energji bërthamore Euroatomi është burimi primar i së drejtës evropiane. (*Zahiti: fq. 31-32*).

3.5 Roli i BE-së në procesin e ndërtimit të institucioneve në Kosovë

Bashkimi European ka role dhe detyra të shumta në Kosovë. Kosova mbetet një shtet me besim të plotë për të qenë kandidat potencial për anëtarësim në BE dhe si një pjesë e procesit të zgjerimit. Edhe pse pesë vendet anëtare të BE nuk e kanë njohur Kosovën, Bashkimi European në saje të kapaciteteve dhe angazhimeve të veta përmes misioneve vepruese është shumë aktiv në Kosovë, duke ndihmuar e përafuar me afër me BE-në. Kjo është e dukshme kohëve të fundit dhe atë përmes misionit EULEX ku, Bashkimi European tani faktikisht mbetet bashkëpunuesi më i madh i proceseve zhvillimore në vend e më gjerë. Misionet e këtilla kanë treguar se janë të afta për të parandaluar konflikte dhe për të sjellë një prosperitet dhe stabilitet në rajon. (Bajraktari, 2014).

Misionet e BE-së në Kosovë, njëherit kanë interesa politike-ekonomike si model zgjerues e ndërtues të një shteti, që po aplikon në Kosovë. Misionet e këtilla vazhdojnë të jenë për të mirën e Kosovës. Si një vend me një numër të madh të misioneve e organizatave që ishin si të veçanta e specifike për Kosovën, që shpesh herë nga bashkësia ndërkombëtare dhe evropiane Kosovën e quajnë si rast sui generis edhe misionet janë pothuajse të tilla. Pasi që Kosova është ndër vendet më të vona që ka dalë nga lufta në rajon me pasoja tepër të mëdha, si në humbjen e njerëzve, dëbimin, shkatërrim të infrastrukturës së banimit, infrastrukturën ekonomike. Këto realitete e rreshtuan Kosovën në një realitetit të ri, duke ndihmuar në të gjitha sferat për konsolidimin e saj si një shtet funksional, duke i mbrojtur lirinë dhe demokracinë që po ndërton dhe konkretizon vazhdimisht. Prandaj edhe rolet e këtilla janë tejet të domosdoshme.

Qëllim tjetër i rolit të misionit të BE-së kishte të bënte me sektorin e drejtësisë, në luftimin e krimit të organizuar, kontrollin sa më efikas doganor. Të gjitha këto fusha së bashku janë prioritete të misionit të BE-së, që i kishte edhe në vende të tjera që kishin këto probleme pas statusit, që BE-ja i kishte në agjendë brenda misionit të tij. Njëherit Kosova do të ndihmohej financiarisht me shuma të mëdha edhe në të ardhmen. Po ashtu BE-ja kishte një

lloj plani afatshkurtër dy vjeçar që kishte të bënte me involvimin, sigurinë sa më të madhe të Kosovës. Në fillim të vitit 2007, BE-ja themeloi një instrument ndihmës për Kosovën i quajtur me emrin IPA, si qëllim kishte të ndihmonte vendet e Ballkanit Perëndimor në plan përfshihej edhe Kosova. (*Zahiti: fq. 203-204.*)

3.6 Komisioni European

Komisioni është institucion kyç i BE-së. Komisioni ka të drejtë të hartojë propozime për legjislacionin e ri të BE-së, të cilin e dërgon në Këshill dhe Parlament për t'u diskutuar dhe për miratim. Anëtarët e vet emërohen për mandate pesëvjeçare, me anë të marrëveshjes midis shteteve anëtare, e cila pastaj i nënshtrohet miratimit të Parlamentit European. Komisioni aprovohet dhe i përgjigjet Parlamentit European. Komisioni përbëhet nga një anëtar i tij (komisioner) nga çdo vend i BE-së, duke përfshirë edhe presidentin e Komisionit dhe përfaqësuesen e Lartë për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë, e cila është njëra nga zëvendëspresidentët e Komisionit.

Më 9 shkurt 2010, Parlamenti European votoi miratimin e Komisionit aktual 2009-2014. Ish-kryeministri i Portugalisë, Zhoze Manuel Barroso, u riemërua president i Komisionit edhe për një mandat pesëvjeçar. Komisioni gëzon një shkallë të rëndësishme të pavarësisë në ushtrimin e fuqive të veta. Detyra e tij është të përkrahë interesin e përbashkët, gjë që nënkupton se nuk duhet të pranojë udhëzime nga asnjë qeveri kombëtare. Duke e pasur rolin e “Ruajtësit të Traktatit”, Komisioni duhet të garantojë se rregulloret dhe direktivat e miratuara nga Këshilli dhe Parlamenti janë duke u zbatuar në shtetet anëtare. Nëse nuk zbatohen, atëherë Komisioni mund ta nxjerrë palën shkelëse para Gjykatës së Drejtësisë, në mënyrë që ta obligojë të përputhet me Ligjin e BE-së.

Duke e pasur rolin e krahut ekzekutiv të BE-së, Komisioni zbaton vendimet e miratuara të Këshillit në fushat si: politika e përbashkët bujqësore, tregu i brendshëm, konkurrenca, energjia, transporti, zhvillimi rural, arsimi, shkenca, të drejtat e konsumatorit e të tjera. Komisioni ka fuqi të mëdha në menaxhimin e politikave të përbashkëta të BE-së, siç janë hulumtimi dhe teknologjia, ndihma ndërkombëtare dhe zhvillimi rajonal. Komisioni menaxhon edhe buxhetin për këto politika. Komisionerëve u ndihmon shërbimi civil, me seli kryesisht në Bruksel dhe në Luksemburg, i ndarë në 28 drejtori të përgjithshme.

Ekzistojnë edhe disa agjenci të pavarura, të themeluara për zbatimin e detyrave specifike për Komisionin, të cilat janë të vendosura në qytete të tjera të Europës. (*Zahiti: fq. 203-204.*)

3.7 Këshilli i BE-së

Këshilli (i njohur edhe si Këshilli i Ministrave) përbëhet nga qeveritë kombëtare të anëtarëve të BE-së. Shtetet anëtare me ndërrime mbajnë Presidencën e Këshillit për një periudhë gjashtëmujore. Në çdo mbledhje të Këshillit merr pjesë një ministër nga çdo vend anëtar i BE-së. Se cilët ministra marrin pjesë në mbledhje, varet nga tema e parashikuar në agjendën e mbledhjes: punët e jashtme, bujqësia, industria, transporti, ambienti jetësor, etj. Detyra kryesore e Këshillit është miratimi i ligjeve të BE-së. Zakonisht këtë përgjegjësi Këshilli e ndan me Parlamentin Europian. Këshilli dhe Parlamenti gjithashtu kanë përgjegjësi të barabartë lidhur me miratimin e buxhetit. Veç kësaj, Këshilli ka ekzkluzivitetin që të nënshkruajë marrëveshje ndërkombëtare të cilat i ka negociuar Komisioni.

Sipas Traktatit të Lisbonës, Këshilli duhet të marrë vendimet e veta ose me votimin e shumicës së thjeshtë, votimit të “shumicës së kualifikuar” ose unanimisht, varësisht nga tema që duhet të vendoset. Këshilli duhet të arrijë marrëveshje unanime lidhur me çështjet e rëndësishme, siç janë: tatimet, politikat e azilit, ndryshimi i traktateve, përdorimi i politikës së re të përbashkët ose anëtarësimi i një vendi të ri në BE. Në shumicën e rasteve të tjera përdoret votimi i shumicës së kualifikuar. Kjo do të thotë se një vendim i Këshillit miratohet nëse në favor të këtij vendimi është votuar një numër i caktuar minimal i votave. Numri i votave të ndara për çdo vend të BE-së përafërsisht reflekton madhësinë e popullatës së tij. Deri më 1 nëntor 2014, nëse supozojmë se BE-ja ende do të ketë 28 shtete anëtare, një vendim miratohet: nëse së paku 255 nga gjithsej 347 vota (d.m.th. 73.91 %) janë në favor të vendimit; nëse vendimi miratohet nga shumica e shteteve anëtare, d.m.th. së paku 14; nëse këto shtete anëtare përfaqësojnë së paku 62 % të popullatës së BE-së. Prej 1 nëntorit 2014, sipas Traktatit të Lisbonës, ky sistem do të thjeshtësohet. Një vendim do të

miratohet nëse 55 % e shteteve anëtare (d.m.th. së paku 15) votojnë në favor të vendimit dhe nëse këto vende përfaqësojnë së paku 65 % të popullatës së BE-së. (*Zahiti*., fq. 72-77).

3.8 Këshilli European – Samiti i BE-së

Këshilli European është institucioni më i lartë politik i BE-së. Ky institucion përbëhet nga shefat e shteteve ose qeverive — presidentët dhe/ose kryeministrat — e të gjitha shteteve anëtare të BE-së, plus presidenti i Komisionit European dhe Presidenti i Bashkimit European. Këshilli zakonisht mban mbledhje katër herë në vit në Bruksel dhe me hyrje në fuqi të Traktatit të Lisbonës ka presidentin e vet – Herman van Rompuy. Detyra e tij është që të koordinojë punën e Këshillit European, si dhe të përgatisë e kryesojë takimet e Këshillit European. Presidenti zgjidhet (me votim të shumicës së kualifikuar të anëtarëve të vet) për afat prej dy vjet e gjysmë dhe mund të rizgjidhet vetëm një herë.

Këshilli European i cakton qëllimet politike të BE-së dhe përcakton kursin e arritjes së këtyre qëllimeve, por nuk ka kompetenca për të kaluar ligjet. Këshilli stimulon iniciativat e politikës kyç të BE-së dhe merr vendime lidhur me problemet e vështira, të cilat nuk kanë mundur të gjenin zgjidhje nga Këshilli i Ministrave. Këshilli European gjithashtu trajton edhe problemet aktuale ndërkombëtare përmes “politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë” — i cili paraqet një mekanizëm për koordinimin e politikave të jashtme të shteteve anëtare të BE-së. (*Reka, Höll, Sela*: fq 23-24).

3.9 Parlamenti European

Parlamenti European është institucioni që përfaqëson qytetarët e BE-së. Parlamenti mbikëqyr aktivitetet e BE-së dhe së bashku me Këshillin aprovojnë legjislacionin e BE-së. Prej vitit 1979, deputetët e Parlamentit European zgjidhen drejtpërsëdrejti, me të drejtë vote universale. Zgjedhjet për Parlament mbahen çdo pesë vjet, zgjedhjet e ardhshme do të mbahen në verën e vitit 2014.

Parlamenti mban debatet e veta brenda komiteteve në Bruksel në të cilat, në parim, marrin pjesë të gjithë deputetët e Parlamentit European. Derisa seancat plenare çdo muaj zakonisht mbahen në Strasburg dhe zgjasin një javë, seancat plotësuese mbahen në Bruksel dhe

zgjasin 1 ose 2 ditë. Puna përgatitore po ashtu bëhet në Bruksel. “Konferenca e Presidentëve”, d.m.th. kryesuesi i grupeve politike, së bashku me presidentin e Parlamentit përcaktojnë agjendën e seancave plenare, kurse 20 komitetet parlamentare hartojnë ndryshimet legislative, të cilat duhet të diskutohen. Punën e përditshme të Parlamentit e bën sekretariati i përgjithshëm, me seli në Luksemburg dhe Bruksel. Çdo grup politik ka edhe sekretariatit e vet.

Parlamenti merr pjesë në punën legislative të BE-së, në dy mënyra, me anë të “bashkëvendimit”, i cili paraqet procedurën e zakonshme legislative. Parlamenti ka përgjegjësi të barabartë me Këshillin për nxjerrjen e ligjeve në të gjitha fushat politike që duhet të votohen me “shumicë të kualifikuar” në Këshill. Nga hyrja në fuqi e Traktatit të Lisbonës, këto fusha përfshijnë rreth 95 % të legjislacionit të BE-së. Këshilli dhe Parlamenti mund të arrijnë marrëveshje menjëherë pas leximit të parë. Nëse nuk mund të pajtohen edhe pas leximit të dytë, propozimi i dërgohet një komiteti arbitrazhi. Mënyra e dytë, përmes procedurës së “pëlqimit”, Parlamenti duhet të ratifikojë marrëveshjet ndërkombëtare të BE-së (të cilat paraprakisht i ka negociuar Komisioni), duke përfshirë të gjitha traktatet e reja që kanë të bëjnë me zgjerimin e Bashkimit European. Parlamenti European gjithashtu ndan përgjegjësinë e barabartë me Këshillin, lidhur me miratimin e buxhetit të BE-së (të cilin e propozon Komisioni European). Parlamenti mund të refuzojë buxhetin e propozuar, gjë që e ka bërë në disa raste deri më tani. Kur ndodh kjo, e tërë procedura e buxhetit duhet të nisë nga fillimi. Duke përdorur fuqitë e veta buxhetore, Parlamenti ushtron ndikim të rëndësishëm në bërjen e politikës së BE-së.

E fundit madje është që Parlamenti European ushtron mbikëqyrje demokratike mbi Unionin, e veçanërisht mbi Komisionin European. Çdo pesë vjet, kur vjen koha e emërimit të Komisionit të ri, Parlamenti i zgjedhur european mundet — me votimin e shumicës së thjeshtë — të miratojë ose refuzojë të nominuarit e Këshillit European për postin e presidentit të Komisionit. Është e qartë se ky votim do të reflektojë rezultatet e zgjedhjeve të fundit të Parlamentit European. Parlamenti gjithashtu interviston të gjithë kandidatët e propozuar të Komisionit para se të votojnë miratimin e Komisionit të ri në përgjithësi. Në çdo kohë Parlamenti mund të shkarkojë gjithë Komisionin duke miratuar një propozim

kundërshtimi. Për këtë duhen dy të tretat e shumicës në Parlamentin Europian. Parlamenti gjithashtu mbikëqyr edhe menaxhimin e përditshëm të politikave të BE-së, me ç'rast Komisionit dhe Këshillit i dorëzohen pyetjet me gojë dhe me shkrim. (*Reka, Höll, Sela: fq 29-30*).

3.10 Gjykata Europiane e Drejtësisë

Gjykata Europiane e Drejtësisë, me seli në Luksemburg, përbëhet nga një gjykatës prej çdo shteti të BE-së dhe tetë anëtarë të përgjithshëm që kanë rolin e ndihmësve. Ata emërohen me marrëveshje të përbashkët të qeverive të shteteve anëtare, me mundësi të ripërtëritjes së mandatit gjashtëvjeçar. Paanshmëria e tyre është e garantuar. Roli i Gjykatës është të garantojë ekzistimin e përputhshmërisë me ligjet e BE-së, dhe interpretimin dhe zbatimin korrekt të traktateve. Gjykata e Drejtësisë garanton respektimin e plotë të së drejtës së Bashkimit Europian. (*Reka, Höll, Sela: fq 31-34*).

3.11 Banka Qendrore Europiane

Banka Qendrore Europiane, me seli në Frankfurt, përgjigjet për menaxhimin e euros dhe të politikës monetare të BE-së. Detyra kryesore e Bankës është që të ruajë stabilitetin e çmimeve dhe të politikës monetare në zonën e euros. Me Traktatin e Lisbonës, Banka Qendrore ka fituar statusin e institucionit të BE-së

Gjykata Europiane e Auditorëve

Gjykata Europiane e Auditorëve, me seli në Luksemburg, u themelua në vitin 1975. Kjo Gjykatë përbëhet nga një anëtar i secilit shtet të BE-së, të emëruar për mandat gjashtëvjeçar, me marrëveshje midis shteteve anëtare, pas konsultimit me Parlamentin Europian. Kjo Gjykatë kontrollon nëse janë pranuar të ardhurat e Bashkimit Europian, nëse të gjitha shpenzimet janë bërë në mënyrë të rregullt dhe ligjore dhe nëse buxheti i BE-së është menaxhuar me vend. (*Reka, Höll, Sela: fq 37-38*).

3.12 Komiteti për Çështje Ekonomike dhe Sociale

Kur merr vendime në disa fusha politike, Këshilli dhe Komisioni konsultohen me Komitetin Ekonomik dhe Social Europian (EESC). Anëtarët e tij përfaqësojnë grupet e ndryshme ekonomike dhe sociale, të cilat kolektivisht përbëjnë “shoqërinë e organizuar

civile”, dhe emërohen nga Këshilli për mandat pesëvjeçar. Komiteti mund të lëshojë opinione edhe me iniciativë të vet. (*Reka, Höll, Sela: fq 39*).

3.13 Komiteti i Rajoneve

Komiteti i Rajoneve përbëhet prej përfaqësuesve të qeverive rajonale dhe asaj lokale. Përfaqësuesit e këtij Komiteti i propozojnë shtetet anëtare dhe i emëron Këshilli, po ashtu me mandat pesëvjeçar. Këshilli dhe Komisioni duhet të konsultojnë Komitetin e Rajoneve lidhur me çështje relevante për rajonet europiane e sidomos për politikën e zhvillimit rural dhe rajonal. Gjithashtu edhe ky Komitet mund të lëshojë opinione me iniciativë të vet. (*Zahiti: fq. 138-139*).

Banka Europiane për Investime

Banka Europiane për Investime (EIB), me seli në Luksemburg, ofron kredi dhe ndihmon rajonet më pak të zhvilluara të BE-së. Gjithashtu Banka ndihmon bizneset që të jenë më të denja për konkurrencën në tregun e brendshëm të BE-së. (*Zahiti:, fq. 139-141*).

4 PROCESI I ANTARËSIMIT NË BE

Alternativa e BE-së ishte standardizimi dhe anëtarësimi i Kosovës në strukturat Europiane. Rrugët demokratike që i ofroi Bashkimi European Kosovës tash e shumë kohë janë rrugët që po i sjellin stabilitet edhe rajonit, por kjo nuk ishte një punë e lehtë për t'u arritur. Këto objektiva madhore që ishin caktuar për Kosovën duhej kohë që frytet e suksesit të arriheshin. Për të ardhur deri të këto reformat institucionale, ishte i nevojshëm dhe përkushtimi i përbashkët european e ndërkombëtar. Rrugët në ndërtimin, rregullimin e shtetit, reformimin juridik të të drejtave në përgjithësi dhe reformave institucionale ishin dhe mbetën çelësi kryesor për shtetin e Kosovës dhe më gjerë. Këto reforma kishin qëllim që t'i sillnin Kosovës një efikasitet më të garantuar nga ana e këtyre institucioneve për të gjithë qytetarët e tyre pa dallim kombësie, race dhe feje. Këto institucione pasi u ndërtuan gjatë viteve të fundit nga ana e BE-së, së bashku me institucionet vendore dizajnuan dhe instaluan institucione me standarde demokratike, ngase edhe Kosova e kërkonte një gjë të tillë, në mënyrë që këto institucione t'i qëndrojnë kohës dhe të ndjekin ritmet dhe modelet e demokracive europiane. Mirëpo, duke shikuar nga ky prizëm demokratik, Kosova është futur drejt një standardizimi dhe një përkushtimi për të bërë reformat e këtilla që japin dhe çelësin përkatës për të hapur portën e BE-së. Nuk do të mjaftonte vetëm ky çelës për të shkuar deri tek kjo portë, mbeten shumë rrugë për t'u bërë në vitet në vazhdim për të lëvizur Kosovën drejt rrugës europiane.

Një ndihmë tjetër ishte edhe bashkëpunimi me Zyrën e Komisionit European të hapur që kishte si qëllim të ndihmonte Kosovën në rrjedhat e reformave ekonomike, integrimin territorial të Kosovës dhe realizimet dhe shtruarjen e këtyre rrugëve drejt BE-së. Kosova ka nevojë për ndryshime reformatike. Njëkohësisht kërkohet të zgjidhen shumë probleme ekonomike e politike të vazhdueshme, e cila iniciativë për reforma do të ishte më së miri në bazë të studimeve nga autoritete politike në përgjithësi, si qëllim i përbashkët ndërtues. Përmirësimi i këtyre fushave do të krijonte kushtet e domosdoshme të kërkuara për integrim dhe anëtarësim. Një punë e tanishme dhe në të ardhmen që mbetet për të bërë

është përmbushja e kriterëve që ka caktuar dhe do të caktojë në të ardhmen Bashkimi Europian Kosovës.

4.1 Përmbushja e Kriterëve (Kriteret e Kopenhagës)

Synimi kryesor i Kopenhages ishte përmbushja e standarteve si parim dhe forcim i shtetit ligjor, të drejtat e njeriut, respektimi i pakicave, një ekonomi funksionale e tregut dhe përmbushia e legjislacionit. Pas vitit 1993 ishte periudha më konfliktuozë me lufta të brendshme në gjithë rajonin e ish Jugosllavisë. Të gjitha këto ngjarje ndikuan negativisht dhe penguan procesin e zbatimit të kriterëve të Kopenhagës. Me përfundimin e këtyre konflikteve brenda ish-Jugosllavisë, sidomos me mbarimin e Luftës në Kosovë, Bashkimi Europian miratoi një iniciativë të re për pesë shtetet e rajonit, ku përfshihen: Shqipëria, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Mal i Zi. Kjo iniciativë u emërua si Procesi i Stabilizim Asocimit, e cila u miratua një vit pas miratimit të iniciativës së Këshillit Europian për procesin e Stabilizim Asocimit. Në këtë kontekst në vitin 2000, u mbajt Samiti i Zagrebit. Bashkimi Europian, që nga ajo kohë dha mesazhe të qarta për shtetet e Ballkanit Perëndimor, ku theksohej: “Që rruga e tyre drejt BE-së është e hapur, në këtë Samit u miratua programi CARDS”.

Marrëveshjet e Bashkimit Europian, ishin të qarta, që secili vend i Europës mund të aplikojë për anëtarësim, nëse respekton parimet e lirisë, demokracisë, të drejtat e njeriut e liritë themelore, si dhe sundimin e ligjit. Inkuadrimi megjithatë, mund të pasojë vetëm nëse secili vend europian përmbush të gjitha kriteret për anëtarësim, të njohura edhe si Kriteret e Kopenhagës. Këto kriterë janë vënë nga Këshilli Europian në Kopenhagë më 1993, që njihen si Kriteret e Kopenhagës si:

- Kriteri politik;
- Kriteri ekonomik;
- Kriteri juridik. (*Zahiti*., fq. 203-204).

4.2 Kriteret politike-juridike:

Kriteret politike për Kosovën nënkuptojnë një numër të madh të tyre, si: ndërtimin e institucioneve stabile që garantojnë demokracinë funksionale, sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut si dhe respektimit të pakicave dhe mbrojtjen e tyre. Kriteri juridike, si njëri nga kriteret më shumë sfida që do angazhim dhe punë të madhe njëherit nënkupton; aftësimin e shtetit për të implementuar Acquis Communautaire (të tërë legjislacionit Europianë) dhe vënia e efikase e tij në jetë përmes strukturave gjegjëse administrative dhe sundim të ligjit.

4.3 Kriteret ekonomike:

Një ekonomi funksionale tregu, aftësia për t'u përballur me konkurrencën dhe fuqinë e tregut brenda BEE-së, të ketë zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm. Kapaciteti për t'i marrë përsipër obligimet e anëtarësimit, përfshirë këtu edhe ndjekjen e objektivave për një union politik, ekonomik dhe monetar. Kosova në shumë nga këto çështje është në fazat e saj fillesare dhe kapacitetet e tanishme i ka si në aspektin infrastrukturor, bujqësor dhe ekonomik.

4.4 Kriteret Europiane

Kanë të bëjnë me aspektet e caktuara të acquis të komunitetit, më sakësisht, në tregun e brendshëm (levizja e lirë e mallërave dhe kapitalit, doganat dhe tatimet, prokurimi publik, ligji dhe statistikat mbi pronën intelektuale), politikat sektoriale (industria dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, zhvillimi rural, ambienti, transporti, shoqëria e informimit e mediat, dhe kontrolli financiar) dhe fusha e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, (vizat, kontrolli kufitar, kërkimi i azilit dhe emigrimi, larja e parave, dogana dhe policia; lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit). Në këto fusha, Kosova duhet të harmonizojë legjislacionin e saj me Acquis të Komunitetit dhe ta sigurojë zbatimin e këtij legjislacioni. Kosova po ashtu duhet të zhvillojë dhe forcojë kapacitetet administrative për t'u siguruar që politikat dhe legjislacioni i saj t'i përmbushin kërkesat e BEE-së dhe t'i zbatojë standardet e BEE-së.

(*Zahiti*., fq. 205-206).

4.5 Procesi i antarësimit në UE

Antarësimi i një shteti në unionin evropian, nuk është një akt por një process i gjatë i komplikuar dhe jo gjithnjë i sigurtë.

Procesi i antarësimit është dhe mbetet orientim strategjik i gati çdo shteti evropian.

Unioni evropian kërkon nga shtetet që as aspirojnë antarësimin t'i plotësojnë disa kushte të cilat vet shtetet anëtare nuk i përfillin.

Shtetet e reja anëtare nga Evropa qendrore dhe lindore të cilat në vitin 2004/2007 ishin antarësuar në UE në fazën e parë të antarësimit, ishin të detyruara të garantonin respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare në teritorin e tyre Qysh në traktatin e Romës për BEE-në ishin përcaktuar tërthorazi kushtet për anëtarësim interpretimi i parë i tij një tentim që të formalizohen kriteret për anëtarësim ishte bërë në raportin e Birkelbach-ut të vitit 1962 me të cilin ishin përcaktuar domosdoja e të qenit shtet demokratik për tu bërë shtet anëtar i BEE-së. Me 9 shkurt të vitit 1962 BE-ja nuk e kishte pranuar Spanjën sepse mendohej në atë botë që Spanja nën regjimin e Frankos nuk ishte shtet demokratik.

Për të qenë shtet demokratik Traktati i Mastrihitit e kishte zgjeruar formimin juridik të kushteve për anëtarësim në UE në formimin tashmë të njohur “çdo shtet evropian që i pranon vlerat e përbashkëta evropiane”.

Kriteret formale për anëtarësim- të bëhesh shtet anëtar i UE-së është një mundësi që i jepet një shteti evropian (përcaktimi gjeografik) në qoftë se u përmbahen vlerave të përbashkëta evropiane (përcaktimi civilizues), dhe vetëm atëherë kur i plotëson kriteret e Kopenhagës të vitit 1995 (standardet administrative).

Pra, secili shtet që aspirojnë për tu anëtarësuar në UE duhet t'i plotësojë katër kriteret:

1. Kriteri politik apo funksionimi i demokracisë parlamentare dhe egzistimi i stabilitetit politik të institucioneve stabile i studimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit, gjyqësi të pavarur, respektimi i të drejtave të njeriut dhe pakicave.
2. Kriteri juridik apo harmonizimi i legjislacionit kombëtar me atë të UE-së e deri të inkorporimi i së drejtës së UE-së në këtë legjislacion pozitiv të shtetit aspirant.

Në gjysmen e vitit 2008 presidenti francez në kuadër të prioriteteve të veta presidenciale kishte aktualizuar nevojën e ngritjes profesionale në fushën e të drejtës së UE-së për gjyqtarët dhe prokurorët e shteteve anëtare si parakusht të funksionimit të gjyqësisë së UE-së.

3. Kriteri ekonomik apo kriteri që kërkon plotësimin e standardeve sikur që janë funksionimi i ekonomisë së tregut dhe tregu i lirë dhe i hapur pa kufizime administrative e shtetërore dhe kapaciteti për ta përballuar me forcen konkurrese brenda tregut të US-ë.

4. Kriteri ekonomik apo kushti plotësues i Madridit 1995 nënkuptonte kapacitetin administrative të një shteti, aftësinë e administratës shtetërore për t'i zbatuar normat dhe politikat e unionit evropian.

Kriteret jo formale për anëtarësimin pos këtyre kriterëve formale të lartpërmendura, gjatë çdo procesi të zgjerimit ishin marrë parasysh edhe dy kritere tjera jo formale, që nuk kishin të bënin aq më shtetet aspirante sa me vetë union evropian. Pavarësisht saj shtetet i plotësojnë kriteret formale të anëtarimit, ai do të duhej të mbante llogari edhe për dy kritere shtesë jo formale.

Kapaciteti absorbues/integrues i UE-së në periudhën 2005-2007 në shtetet anëtare të UE-së dominonin debatet nëse pos tri kriterëve të njohura të Kopenhagës dhe atij të Madridit, kriter ishte edhe kapaciteti absorbues i unionit evropian për të pranuar anëtarë të rinjë.

Solidariteti në interesat e shtetit anëtar-anëtarësimi në UE është para se gjithash proces gjeopolitik që merr në konsideratë pos parimeve dhe standardeve të pëcaktuara po aq interesat e shteteve anëtare, fjalën përfundimtare e kanë shtetet anëtare dhe jo burokracia e Brukselit. Unioni Evropian nuk i do problemet e pa zgjidhura politike mes shteteve që pretendojnë anëtarësimin dhe as bartjen e kontesteve territoriale të shteteve të reja anëtare të UE-së, ato duhet zgjidhur paraprakisht para se të anëtarësohen në UE.

-Strategjitë e zgjerimit të UE-së politika e zgjerimit të unionit evropian ishin zhvilluar përmes strategjive të ndryshme të cilat ishin zbatuar pastaj me instrumente të ndryshme, ku përmes të cilave UE-ja vendoste marrëdhënie me shtetet që e aspirojnë anëtarësimin.

Deri më sot janë të njohura tri kategori të këtyre instrumenteve strategjike për zgjerimin e unionit evropian.

-Marrëveshja e asocimit në BE, që kryesisht ishin shfrytëzuar për aderimin e shteteve të Evropës perëndimore deri në mesin e viteve të 90-ta.

Marrëveshjet Evropa apo marrëveshjet e UE-së për shtetet e Evropës lindore dhe qendrore përmes të cilave ishin zhvilluar procesi i zgjerimit të unionit në lindje nga fundi i viteve të 80-ta deri në vitin 2004 respektivisht 2007.

-Marrëveshjet për stabilizim asocim apo marrëveshja e gjeneratës së re me të cilat udhëhiqet aktualisht procesi i zgjerimit me shtetet aspirante të ballkanit perëndimor.

Deri në vitin 1999 kur ishte inaguruar procesi i stabilizim asocimit për Ballkanin perëndimor, asenjëra nga këto vende të këtij rajoni nuk kishin qenë të përfshira më herët në ndonjë proces integruar në UE-në.

Shqipëria si dhe ish RSFJ-ja sikur as shtetet e reja që dolën nga hapësira e ish –Jugosllavisë deri në fillim të shekullit XXI, nuk ishin të përfshira në ndonjë strategji integruar të UE-së, as që ishte ofruar prespekti për anëtarësim në union.

Në vitet e 80-ta ish RSFJ-ja konsiderohej se ishte më e avancuar në krahasim me vendet e tjera të bllokut komunist të lindjes dhe që do të mundë të hynte realisht në prospektet e anëtarësimit të BEE-së së atëhershme, po ashtu kishte ngelë jashtë skenave asociuse me BEE-në e atëhershme. Marrëveshjet BEE dhe ish RSFJ-ja ishin vendosur me marrëveshjet për bashkëpunim në vitin 1980 ku përcaktohej bashkëpunimi tregtar në kohë zgjatjen prej 10-vitesh. Pas nisjes së luftës në ish-jugosllavi Brukseli kishte bërë përpjekje që duke ofruar një mundësi asociuse ish-jugosllavisë ta shpetonte atë nga dislucioni shtetëror.

Në maj të vitit 1991, BEE-ja i kishte ofruar RSFJ-së nënshkrimin e marrëveshjes për asocim si dhe ndihmë ekonomike, por kjo ofertë ishte refuzuar nga qeveria e ish-Jugosllavisë.

Në vitin 2005 unioni evropian inaguroi një strategji të re të zgjerimit, kjo strategji e re dallonte nga ajo e mëparshme që ishte aplikuar në vitet e 90-ta ndaj vendeve të Evropës qendrore dhe lindore në këta 8 parametra:

1. Strategjia e re e zgjerimit është më e kushtëzuar, me kushte më strikte, në krahasim me ato që në vitet e 90-ta duhet t'i përmbushnin vendet që aspironin anëtarësimin.

2. Pos kushteve standarde, kriter i Kopenhagës/Madridit, kërkohet plotësimi edhe i kriterëve shtesë politike dhe të sigursisë.
3. Pos plotësimit të “detyrave të shtesipisë”, shteteve ju kërkohet edhe kujdesi për marrëdhënie të mira me fqinjët.
4. Në vend të çasjes grupe përcaktohet çasja e meritave individuale të secilit shtet veç e veç.
5. Tash e tutje vetëm shtetet candidate, me datë të përcaktuar për fillimin e negociatave për anëtarësim, mund ta fillojnë procesin e screening-ut dhe jo siç ishte më parë të gjitha shtetet candidate.
6. Shtohet vëllimi i *acquis* komunitare nga 31 sa ishin në 33 kaptina.
7. Pa përmbylljen e suksesshme të kaptinës që negociohet nuk mund të hapet kaptina e re.
8. Një herë negociatat e filluara nuk do të thotë se patjetër edhe do të përfundohen, sepse tash e tutje përcaktohet mundësia që në çdo fazë të bisedimeve ato do të mund të ndërpriten, nëse UE-ja vlerëson se shteti kandidat nuk u përmbahet kriterëve themelore për anëtarësim.

Pas inagurimit të kësaj strategjie të re për zgjerim unioni evropian përcaktoi kushte rigorozë për anëtarësimet e reja, ku në plotësimin e të cilave fitohet garanci se kandidatët do t'i përmbushin në tërësi para se të anëtarësoheshin në union, ku në bazë të këtij kondicionaliteti do të mundë të bëhej edhe diferencimi i tyre në këtë proces.

Shtetet aspirante të ballkanit perëndimor kushtëzimi i komisionit evropian ndaj tyre ishte i dyfishtë ato duhej t'i plotësonin në mënyrë të përpiktë kriteret e Kopenhagës/Madridit, por edhe detyrimet nga marrëveshja për stabilizim asociativ.

Në lehtësimin e deritanishëm të zgjerimit për kundër veshtersimit të zgjerimit aktual ndikuan në shumë faktorë:

1. Rrethanat gjeopolitike në vitet e 70-ta, 80-ta dhe të 90-ta, ishin në dyshe nga ato në fillim të këtij shekulli, më favorizuese për zgjerimin se sa sot.
2. Deri në zgjerimin e parafundit 1995 as që egzistonin kriteret e Kopenhagës/Madridit, ndërkaq *acquis* komunitare ishte më e thjeshtë.
3. Më tutje atëherë as që flitej për kapacitetin absorbues të UE-së për të pranuar në gjirin tij anëtar të rinj, sepse BEE-ja ashtu edhe UE-ja funksionon institucionalisht me traktatet

ekzistuese brenda kufijeve normalë.

4. Entuziazmi për të pranuar anëtar të rinjë si në Bruksel ashtu edhe nga qeveritë e kryeqyteteve evropiane.

5. Kjo lodhje nga zgjerimi siç u tha në laborimet paraprake ishte pasojë e lodhjes institucionale të UE-së, apo lodhje nga reformat e papërfunduara institucionale të unionit të dekadës së parë të këtij shekulli, të filluara me traktatin e dështuar kushtetues 2002-2007 dhe të rumbullakësuar me fuqizimin e traktatit reformues 2007-2009.

6. Kriza botërore finaciare dhe recesioni i përgjithshëm në Evropë 2008-2009, vështirsoi edhe më tutje skepticizmin edhe ashtu prezent ndaj zgjerimeve të reja të UE-së.

Synim themelor i secilit shtet aspirant nuk duhet të jetë që të gjitha reformat të tij konform kritereve të UE-së të bëjë për shkak të Brukselit, por para se gjithash për veten dhe për benefitet e qytetarëve të tij.

Suksesi në procesin deri të anëtarësimit në UE e determinojnë këta katër faktorë kyç:

1. Vullneti politik për ta realizuar anëtarësimin në UE si objektiv strategjik kombëtar
2. Konsensusi i brendshëm ndëretnik sidomos në shtetet multietnike për integrimin e shtetit përkatës në UE.
3. Mbështetja e qytetarëve për anëtarësimin në UE.
4. Kapaciteti administrativ për ta jetësuar këtë objektiv.

Si fillim duhet ekzistuar dëshira e sinqertë e një shteti për tu anëtarësuar në UE dhe vullneti i elitës politike në pushtet që ta qojë përpara këtë proces strategjik.

Pa pasur unitet të mbrendshëm politik të të gjithë faktorëve politik relevantë dhe të shoqërisë civile në menyrë që ky vullnet politik pastaj të shëndrrohet në aksion praktik të zbatimit administrativ vështir se mund të arrihet në cakun e fundit anëtarësimin në UE.

Uniteti strategjik i tërë shoqërisë së një shteti aspirant është shumë i nevojshëm sidomos për shoqëritë multietnike ku kërkohet një koncensus ndëretniki për këtë anëtarësim.

Suksesi i një shteti që aspiron të anëtarësohet në UE vlerësohet si sukses ose mos sukses i tërë shoqërisë pra edhe i qeverive dhe shoqërisë civile, ku roli i shoqërisë civile në këtë proces është i pa zëvendësueshëm.

Disa shtete anëtare gjatë presidencës së tyre në unionin evropian pos shtetit të tyre e inkuadronin edhe popullin dhe shoqërin civile gjatë udhëheqjes me presidencën në UE, siç bëri Franca në gjysmën e dytë të vitit 2008.

4.6 Forcimi i shtyllës ligjore dhe përshtatja e legjislacionit të Kosovës

Nga momenti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës, një ndër prioritetet e adresuara ishte ndërtimi, zhvillimi dhe forcimi i shtetit dhe i sistemit ligjor, përafrimi i politikave ligjore me BE-në, që njëherit këto veprime na jepnin çelësin e duhur për të hapur dyert e BE-së dhe të ardhmen e vendit në këtë rrugëtim. Kosovës urgjentisht i duhet të bëjë reforma të shpejta në sundimin e ligjit dhe implemetimin e tij në praktikë, adresim tjetër mbetet ndërtimi i kapaciteteve administrative, fuqizimi i ekonomisë me qëllim për të synuar fillimin e proceseve me BE-në si dhe në përshejtimin e nënshkrimit të marrëveshjes së Stabilizim dhe Asocimit (SAA), kur dihet se Kosova ka mbetur e fundit në rajon sa i përket lidhjeve kontraktuale me BE-në, e cila marrëveshje do t'i përcaktojë të drejtat dhe detyrimet si tregues i Kosovës në këtë rrugëtim. Një mbështetje në forcimin dhe luftimin e dukurive kriminale-korrupsionit janë edhe adresimet e njëpasnjëshme që bëhen vazhdimisht nga ana e Parlamentit Evropian, duke i treguar qartë Kosovës se duhet sa më parë të bëjë ndërtimin e marrëdhënieve ekonomike, shoqërore dhe politike me qytetarët brenda dhe në mënyrë që të bëhet faktorizimi i shtetit të Kosovës. (Bajraktari,2014).

BE-ja prej shumë kohësh ishte e interesuar për të filluar negociatat për një marrëveshje kornizë me Kosovën për pjesëmarrjen e saj në programet e BE-së, dhe atë që nga paslufta deri në ditët e sotme. Ky intensitet çdo herë e më shumë po bëhet si domosdoshmëri në konkretizimin e këtyre marrëdhënieve. Për të ardhur deri te kjo, Kosovës do të duhej të shtojë përpjekjet që të luajë një rol sa më konstruktiv në politikëbërje dhe qeverisje, duke përdorur të gjitha mundësitë e ofruara dhe të rregulluara me kushtetutën e Kosovës. Autoritetet e Kosovës duhet të tregojnë sa më shumë vullnet politik e praktik për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, e cila dukuri përkundrazi fatkeqësisht po fuqizohet sidomos në veri të Kosovës.

Fillimisht u formuan: bashkësia evropiane për thëngjill dhe çelik, bashkësia evropiane për energji bërthamore, dhe bashkësia ekonomike evropiane.

E gjithë kjo formë e bashkëpunimit të shteteve evropiane nuk mjaftonte për ta arritur integrimin e plotë evropian, prandaj u parashtrua nevoja që këto bashkësi evropiane të bashkohen për ta bërë bashkëpunimin evropian sa më efektiv, dhe për ta shtyrë procesin e integritit evropian përpara. (*Reka*, fq.279-297).

4.7 INSTITUCIONET E BE-SË

Bashkimi European (BE) është bashkim ekonomik dhe politik i 28 shteteve anëtare. BE-ja operon nëpërmjet sistemit të institucioneve supernacionale të pavarura dhe vendimeve ndërqeveritare të negociuara nga shtetet anëtare. Institucionet kryesore të BE-së janë: Komisioni European, Këshilli i BE-së, Këshilli European, Parlamenti European, Gjykata Europiane e Drejtësisë, Banka Qendrore Europiane dhe Gjykata e Auditorëve. (*Reka, Höll, Sela*: , fq 23).

5 DEKLARIMI I PROBLEMIT

Hulumtues të ndryshëm janë marrë me çështjet e integritit të Kosovës në BE dhe kanë shqyrtuar pikat më të ndjeshme sa i përket plotësimit të standardeve dhe kushteve të nevojshme për anëtarimin në këtë organizatë europiane.

Halim BAJRAKTARI - kandidatë për doktoraturë, në Tiranë ka shqyrtuar temën “ Roli dhe Perspektiva Europiane e Kosovës “ dhe në bazë të përbledhjes së kësaj teme ka arritur në përfundim se Kosova ka arritur një përparim në shtetndertimin e saj falë ndihmës dhe punës së saj shumëvjeqare deri te finalizimi i pavarësisë më 17 shkurt 2008 dhe pas saj. BE-ja po i jep një zhvillimi dhe orientim të duhur institucioneve në tërësi, formimit të sektorit ligjor në veçanti, në implementimin e politikave integruese etj, por në tjetrën anë nga pavarësimi nga Qeveria e Kosovës kërkohet që të punojë ngushtë edhe për një kohë në vazhdim me përfaqësues ndërkombëtarë, ngase janë interesa dhe njëherit një përfitim për ne, sidomos përmes prezencës së misionëve e sidomos me EULEX-in dhe atë në sundimin e rendit dhe ligjit në mënyrë me të qartë së bashku për të përmbushur agjendën dhe për të pasur një perspektivë europiane. Rekomandimet e të cilit janë: Rritja e aftësive të lidershit për përkushtimin më të qartë mbi rolin dhe perspektivën europiane të Kosovës dhe një nismë nga institucionet tona për të rritur ndërgjegjësimin për rendësinë dhe shkallët politike-ekonomike e juridike që duhet ecur gjatë integritit të Kosovës në Bashkimin European.

Erlir PUTO kandidatë për doktoraturë, në Tiranë ka shqyrtuar temën “Përshtatshmëria e Normativës së Huaj e në veçanti e Bashkimit e European me sistemin e brendshëm ligjor e administrative shqiptar” Nga shqyrtimi i kësaj teme ai ka arritur në përfundim se BE ka ndikimin në çdo sferë ligjore të vendeve në tranzicion duke marrë parasysh administratën shtetërore dhe çdo sferë publike që ka të bëjë direkt me zhvillimin adekuat të çdo vendi.

6 METODOLOGJIA

Në këtë punim mbi Integrimin Evropian do të merremi me institucionin, që i ka vënë qëllim vetes "të arrijë një bashkim gjithnjë e më të ngushtë të popujve të Evropës". Këtu do të trajtohen para së gjithash çështje mbi nocionin e Integritimit Evropian, historikun dhe zhvillimin e Integritimit Evropian, si dhe motivet e shteteve për tu integruar në këtë Institucion. Si të dhëna primare janë përdorur librat ëbsajtet. Studimi është në radhë të parë informues jo sipërfaqësor, që gjithësecili mund t'i kuptoj lehtësisht.

6.1 Objektivi i studimit

- Objekti i Integritimeve europiane dhe fazat e saj.
- Kuptimi dhe rëndësia e Bashkimit Evropian.
- Integritimit i Kosovës.

6.2 Qëllimi i studimit

Ky studim ka si qëllim të përcaktoj rëndësinë e Bashkimit Evropian, dhe shtetet anëtare që janë pjesë e kësaj organizate. Bashkimi Evropian synon të arrij marrëveshjet midis shteteve të cilat synojnë zhvillimin dhe edukimin e popujve të ndryshëm.

Studimi synon:

- Të kuptojmë rolin e BE-së.
- Zhvillimin e shteteve të ndryshme.
- Dhënien e disa konkluzioneve dhe rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes.

7 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Integrimi Evropian duhet të shihet në radhë të parë si shans për përparim të gjithanshëm në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Përmasat kryesore të këtij procesi tërësor janë demokracia dhe prosperiteti ekonomik, sigurimi i brendshëm dhe i jashtëm, kontributi për paqen në shkallë të gjerë, emancipimi i gjithanshëm i individit dhe i shoqërisë. Kështu kemi mbërritur në mbyllje të kalimit tonë përmes historisë së BE-së dhe përjekjeve tona për të shpjeguar zhvillimin e procesit të integritit. Shpresoj, që me gjithë këtë që përmenda deri tani, kam mundur t'ju vë në dispozicion një instrument, i cili do t'ju ndihmojë për të shpjeguar dhe kuptuar jo vetëm ngjarjet e së shkuarës, por edhe ato të së tashmes dhe të së ardhmes në lidhje me Integrimet Evropiane. Programi i integritit evropian përmbledh një tërësi aktivitetesh, iniciativash dhe bashkëpunimesh të cilat në përgjigje të sfidave të integritit, synojnë të arrijnë brenda kornizave strategjike afat-mesme dhe afat-gjata objektiva të cilat i shërbejnë zhvillimit të institucioneve demokratike, transparencës në vendim-marrjen e të gjitha niveleve, si dhe forcimit të zbatimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të individit. Këto objektiva nuk janë zgjedhje rastësore, por synojnë përmirësim e praktikave të qeverisjes në nivel vendor dhe qendror në Shqipëri përmes aftësisimit dhe konsolidimit të një administrate publike efektive në kryerjen e detyrave dhe shërbimeve, duke sjellë shtetin sa më pranë qytetarit. Situata aktuale në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian, imponon një monitorim të ngushtë të performancës së institucioneve publike dhe nxitjes së debatit publik, për të siguruar se ka progres në të gjitha nivelet.

REFERENCAT

(Paskal Milo: “Bashkimi Evropian”, 2002, Tiranw).

(Blerim Reka, Otmar Höll, Ylber Sela: “ Institucionet dhe politikat e unionit evropian”, fq 23-24).

(Blerim Reka, Otmar Höll, Ylber Sela: “ Institucionet dhe politikat e unionit evropian”,

(Bashkim I. Zahiti: “E drejta evropiane”, fq. 205-206).

(Blerim Reka: “ Gjeopolitika dhe teknika e zgjerimit të U.E”, fq.279-297).

(Blerim Reka, Otmar Höll, Ylber Sela: “ Institucionet dhe politikat e unionit evropian”, fq 23).

Revistë shkencore e përbashkët, n. 1/2. Prishtinë. (Europa, 2007).

Kosova (Diplomacia Imponuese), Tiranë. (Tepshi, Qazim. 1999).

Shtegtimi i Unionit Europian, Prishtinë. (Shehu, Shpresa – Kursani. 2006).

Temë e diplomës. (Bajraktari, Halim 2014)

Temë e diplomës. (Puto, Erlir 2013)

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/06/Doktoratura-Halim-Bajraktari-Instituti-Studimeve-Europiane.pdf> (Kyçur me datën 13.02.2018).

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/09/Doktoratura-Erlir-Puto-Fakulteti-i-Drejtesise-Departamenti-i-te-Drejtes-Publike.pdf> (Kyçur me datën 25.02.2018).

<file:///C:/Users/HP/Desktop/Pershtatja-e-legjislacionit-shqiptar-me-mane-te-be.pdf> (Kyçur me datën 19.03.2018).

<http://www.kcsfoundation.org/?page=1,110> (Kyçur me daten 15.04.2018).

